



Pranuar / Dorezuar Punë / Produkt Received / Delivered	05 - 12 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	In Prot Br / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7674	2022	112



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.950/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.950/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 20.10.2022 të Kryesuesit të Departamentit të Administratës pranë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.950/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, më datë 26.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6462/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.950/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 21.10.2022 dhe rrjedhimisht Vendimit me numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 25.10.2022 të Njesisë se Burimeve Njerëzore pranë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, lidhur me refuzimin e aplikacionit me numër RAN0008315 të datës 05.10.2022 për pozitën e punës “Drejtor i Përgjithshëm 1” me numër reference RN00009875 të shpallur me datë 01.09.2022 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi për refuzimin e aplikacionit për pozitën e punës “Drejtor i Përgjithshëm 1” me numër reference RN00009875 është i kundërligjshme sepse i njëjti konsideron se i ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 09.11.2022 përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me Njoftimin me numër protokolli 3894 të datës 09.11.2022 përmes të cilit shihet se janë shfuqizuar vendimet e kontestuar nga ankuesi, dhe rrjedhimisht sipas Njoftimit me numër protokolli 3980 të datës 16.11.2022 ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë për pozitën e punës "Drejtor i Përgjithshëm 1" me numër reference RN00009875 në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Andaj, meqenëse objekt i ankesës të parashtruar nga ankuesi është kontestimi i ligjshmërisë së Vendimit me numër Ref.003/0-1/KPMM të datës 21.10.2022 përmes të cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni me numër RAN0008315 i datës 05.10.2022, për pozitën e punës "Drejtor i Përgjithshëm 1" me numër reference RN00009875, dhe duke marr parasysh se me Njoftimin me numër protokolli 3894 të datës 09.11.2022 është vërtetuar se vendimi i kontestuar është shfuqizuar nga organi përkatës i punësimit, dhe si rrjedhojë ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë për pozitën e punës "Drejtor i Përgjithshëm 1" me numër reference RN00009875 në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

#### Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.950/2022

**Avdyll BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Jeton KOÇA**

Kryetar i Kolegjit

#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.